



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 423/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur lidhur me ankesën subjektivit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektivit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së njoftimeve, pllakateve dhe posterëve mbi rrugë publike, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Aleancës Kosova e Re (AKR), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik AKR, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, në ankesë theksohet se më datë 10.12.2010 në ora 09:30 është vërejtur se subjekti politik AKR ka vendosur sloganet lidhur me fushatën zgjedhore në rrethojën e ndërtesës publike-Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli” në Prishtinë.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.12.2010, nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se subjekti politik AKR ka vendosur sloganet lidhur me fushatën zgjedhore në rrethojën e ndërtesës publike në Prishtinë që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur gjashtë fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se sloganet e subjektivit politik AKR, janë të vendosur në rrethoj të ndërtesës publike.

Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektivin politik AKR, më datë 10.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjektivit politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më

datë 11.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AKR, sipas afatit të caktuar, mirëpo përgjigjja në ankesë e subjektit politik AKR nuk ka të bëjë me vendin e ngjarjes të cekur në ankesën e subjektit politik LDK, sepse në ankesë thuhet në rrethojën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli” rruga “Fehmi Lladrovci në Prishtinë ndërsa në përgjigje në ankesë thuhet në rrugën “UÇK” në Prishtinë.

Veprimet e Ndalura të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Neni 33 pika (b) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se slogani i subjektit politik AKR është i vendosur në rrethoj të Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli” në Prishtinë, nga kjo arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur po ashtu në pajtim me dispozitat e

lart cekura ligjore PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 423/2010 më datën 12.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

